**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E INDUSTRISE,TRANSPORTIT DHE TREGTISE**
**Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil**

# <u>UDHEZIM</u>

Nr. 81 Date 16.03.95

*PER*

## NXJERRJEN E AUTORIZIMIT DHE CERTIFIKATES SE OPERIMIT AJROR

Ne zbatim te Ligjit Nr.7877, date 30.11.1994 "Per aviacionin Civil", neni 57 per patur nje rregull ne nxjerrjen e autorizimit dhe Certifikates se operimit ajror per personat apo shoqerite e angazhuara ne transportin ajror te pasagjereve, mallit dhe postes,

**U d h e z o j:**

### *A.Te Pergjitshme*

1. Me autorizim dhe Certifikate te Operimit ajror te pajisen vetem agjencite, organizatat, shoqerite tregtare, ndermarrjet shteterore apo private te themeluara sipas ligjeve shqiptare si dhe personat fizik me nenshtetesi shqiptare.

2. Te gjithe personat apo shoqerite qe do te kryejne veprimtari ne transportin ajror te pasagjereve, mallrave dhe postes per qellim fitimi do te zhvillojne kete veprimtari ne baze te autorizimit perkates.

3. Te gjithe personat apo shoqerite te angazhuara me transportin ajror te pasagjereve, mallrave dhe postes lejohen te fillojne operimin vetem pas marrjes se Certifikates te nxjerre nga Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil dhe do te vazhdoje aktivitetin ne perputhje te plote me kushtet e specifikuara ne autorizim dhe certifikaten e operimit ajror.

## B. Nxjerrja e autorizimit .

**4.** Per marrjen e autorizimit personat apo shoqerite duhet te paraqesin ne Ministrine e Industrise, Transportit e Tregtise dokumentet e meposhteme:

a- Kerkesen

b- Pershkrimin e zhvilimit te veprimtarive ne fushen e transportit ajror ku te paraqiten:

- Objektivi dhe synimet e veprimtarise;
- treguesit ekonomik e financiare qe parashikohen;
- çmimet dhe tarifat qe do te perdoren per linje dhe kushtet lehtesuese;
- kontigjenti i punonjesve, pergatitja e tyre tekniko-profesionale dhe programet e treinimit dhe kualifikimit te tyre.

c- Kontraten (aktin) e themelimit te subjektitm, statutin ose rregulloren e funksionimit te tij.

ç- Dokumentet e identitetit per subjektin ekonomik vendas dhe te huaj, si dhe ne rastet kur bashkepunohet me to, duke perfshire:
- veprimtarine ne fushen e transportit ajror, kur ushtron ne vendin e vet ;
- deshmine e penalitetit nga Gjykata e vendit ku personi ka shtetesine per personat praktik te huaj dhe ato shqiptare ne bashkepunim me te huajt.

Dokumentet e identitetit te personelit te huaj duhet te jene origjinale dhe te vertetuara nga administrata shteterore e shtetit qe e leshon dhe te noteruara ne ate shtet. Keto dokumente te jene te perkthyera ne shqip e te noteruara ne vendin tone.

d- Kredibilitetin financiar ;

- Vertetimin e hapjes se llogarise bankare nga banka perkatese shqiptare per fillimin e aktivitetit.
- Vertesimin nga banka qe ka gjendje financiare pozitive per firmat qe kane aktivitet mbi nje vit.

e- Deklaraten per dergimin e informacionit statistikor e kontabel.

f- Mandat arketimi ose mandat-derdhje ne banke te tarifes se pageses per lejen (autorizimin) qe kerkohet.

**5.** Autorizimi te leshohet nga organi kompetent brenda 1 muajve nga koha e paraqitjes se dokumenteve, ne qofte se ato jane te rregullta, ose nga momenti i fundit te permiresimit te tyre.

**6.** Materialet per dhenien e autorizimit do te behet nga nje Komision qe funksionon sipas rregullores te miratuar.

**7.** Autorizimi eshte i pavlefshem ne rast se personi apo shoqerite nuk ka filluar operimin brenda __3__ muajve nga data e leshimit te tij. Ne rastee te vecanta mund te kerkohet shtytje e afatit kur ka aresye objektive te pranuara nga organi kompetent.

**8.** Kohe zgjatja e autorizimit te jete nje vit deri ne 5- vjet, me te drejte perseritje . Kohezgjatja e autorizimit qe jepet per here te pare te jete nje vjecare dhe te sherbeje si kohe prove testimi per subjektin .

**9.** Per perseritjen e autorizimit, pas perfundimit te afatit do te paraqiten keto dokumente:

a- Kerkesa

b- Relacion mbi veprimtarine dhe realizimin e objektivave te caktuara.

c- Relacion nga Albtransporti dhe ANTA mbi zbatimin e rregullave te operimit dhe zbatimin e kontratave nga operatori.

**10.** Autorizimi nuk do te nxirret ne rastet kur operuesi:

- nuk ka besueshmeri financiare
- kur ai eshte denuar me vendim gjykate per vepra penale qe kane patur si qellim fitime te paligjeshme
- ka mungesa ne dokumentacionin e paraqitur.

**11.** Mbas marrjes se autorizimit personit apo shoqerise i lind e drejta e regjistrimit ne Gjykaten e Rrethit dhe ne Regjistrin Tregtar.

## C. Nxjerrja e certifikates se operimit ajror .

**12.** Nje certifikate e Operimit Ajror do te leshohet vetem per personat apo shoqeri te paisura me autorizim .

**13.** Per leshimin e certifikates se operimit ajror duhet te paraqiten dokumentet e meposhteme:

a-vendimin e gjykates per njohjen dhe regjistrimin si person juridik dhe fizik .

b-vertetim per regjistrim ne organet tatimore

c-dokumentet e avionit;

*I. Kur avioni eshte blere:*

- Aktin e blerjes
- dokumentet e cdoganimit
- Deklarata mbi abonimin per dokumentacionin teknik periodik.

*II. Kur eshte marre me qera:*

- Aktin e marrjes me qera
- Kontraten e mirembajtjes dhe sherbimeve teknike

*III. Ne te dyja rastet:*

- Certifikaten e regjistrimit te avionit
- " e vlefshmerise ajrore te avionit
- " e instalimit te radios ne bord
- " e nivelit te zhurmes se avionit
- " e siguracionit te avionit
- Manuali i fluturimit te avionit
- " i mirembajtjes se avionit
- Lista e pajisjeve minimale
- Flete e ballances dhe peshes se avionit.

**d.** Deshmite e aftesive personale te personelit operues (piloteve, teknikeve etj.) konform Aneksit 1 te ICAO-s.

**dh-** Programin e treinimit dhe kualifikimit te personelit.

**e-** Organizimin e operuesit ajror dhe shkallen e kualifikimit te personelit sipas vendit te punes.

**f-** Manualin e operimit te shoqerise, konform standartit 11.1 te Aneksit 6, Pjesa I te ICAO-s.

**g-** Vertetim nga Banka per celjen e llogarise rrjedhese per sasine e fondit te sigurimit per linjen ne shumen sipas percaktimit.

- Transport nderkombetar

per cdo pasagjer ______ x kapacitetin e avionit x 1.5 (koficient) .

- Transport i brendshem

per cdo pasagjer ______ x kapacitetin e avionit x 1.5 (koficient ) .

**e-** Deklarate mbi pajisjen e personit apo shoqerise me standartet e rekomandimet praktike te ICAO-s (Anekset).

**14.** Shqyrtimi e verifikimi i dokumenteve teknike, operacionale te behet nga DPAC brenda __3__ muajve pas dorezimit te tyre.

**15.** Verifikimi i dokumentave tekniko-operacionale nga ana e DPAC mund te jete edhe subjekt miratimi nga nga organe aeronautike te specializuara te huaja mbi bazen e kontrates qe ka kjo drejtori.
Te gjitha shpenzimet e nevojshme ne keto raste perballohen nga personi juridik qe ka paraqitur dokumentacionin.

**16.**Kehezgjatje e Certifikates se operimit ajror te jete 6 mujore dhe 1 vjecare me te drejte perseritje.
Kehezgjatje e Certifikates se operimit ajror qe jepet per here te pare te jete 6 -mujore dhe te sherbeje si kohe prove testimi per subjektin .

**17.** DPAC duhet te krijoje bindje te plote qe operuesi ajror do te operoje me siguri te larte. Per kete ai duhet te demostroje:

a- nje organizim te pershtatshem te operimit
b- nje metode kontrolli dhe mbikqyrje fluturimi

c- te emeroje ne detyra persona kompetente qe kryejne:
- operimet e fluturimit
- mirembajtjen e avionit
- sherbimit ne toke dhe veprimet me biletat.

ç- zbaton programet e treinimit e kualifikimit.

**18.** Certifikata e operimit ajror te permbaje:

- identifikimin e operatorit
- daten e nxjerrjes dhe periudhen e vlefshmerise
- tipin e operimeve dhe llojet e transportit
- tipin e avionit i autorizuar per operim
- vendet apo zonat e autorizuara per perdorim ose rruget
- kufizime.

**19.** DPAC ne vartesi te llojit te operimit vendos per dokumentet tekniko-operacional qe duhet te depozitoje operatori per leshimin e certifikates se operimit ajror.

***D. Te ndryshme***

**20.** Asnje person apo shoqeri i regjistruar ne Shqiperi nuk mund te fluturoje per qellime te transportit ajror tregtar pa qene ne perputhje me kushtet e Certifikates se Operimit Ajror, dhene operuesit nga DPAC dhe te standarteve te Aneksit 6 te ICAO-s.

21. Vetem shoqerite, te cilat jane te regjistruara ne Shqiperi mund te autorizohen dhe te jepet certifikata e operimit ajror per te fluturuar brenda dhe jashte territorit shqiptar me origjine nga Shqiperia.

22. Transport ajror tregtar midis dy pikave (aeroporteve) te lokalizuara ne territorin e Republikes se Shqiperise te lejohen per avione te regjistruar ne Shqiperi dhe jashte saj. Fluturime te vecanta apo te perkoheshme mund te lejohen vetem me urdher te Drejtorit te DPAC.

23. DPAC te ndermarre nje inspektim te vazhdueshem te operimeve te poseduesit te Certifikates se Operimit Ajror konform urdherit Nr. 82 date 16.03.1995 per vazhdueshmerine e vlefshmerise se Certifikates se Operimit Ajror".

24. Personat apo shoqerite qe kane marre Certifikaten e Operimit ajror jane te detyruar te lidhin kontrate per sherbimet ne toke me Albtransportin dhe per sherbimet e trafikut ajror me ANTA.

25. Personat juridik e fizik qe kryejne veprimtari ne fushen e transportit ajror te paraqesin te dhena statistikore (konform nenit 3 te ligjit Nr.7687, date 16.03.1993). Lloji i evidencave, te dhenat e treguesve tekniko-ekonomik dhe afatet percaktohen nga sektori i statistikave te Ministrise se Industrise, Transportit dhe Tregtise dhe DPAC me pelqimin e Institutit te Statistikes.

26. Tarifat e pagesave per llojet e autorizimit, certifikates dhe rinovimit te tyre tregohen ne pasqyren Nr.1 bashkelidhur. (Ne zbatim te pikes 4 te VKM Nr.621 → SHIKO UDHE NR.72. TE M.T.E date 20.12.1993). Ato mund te ndryshohen nga organi kompetent sipas legjislacionit ne fuqi.
Te ardhurat per pagesat e autorizimit dhe Certifikates se Operimit Ajror te derdhen ne llogarine e buxhetit te DPAC.

27. Nuk do te konsiderohet veprinmtari private ne fushen e transportit ajror kerkesat e firmes (shoqerive) te huaja jashte vendit per dhenien e autorizimit e Certifikates se operimit ajror ne linjat e transportit nderkombetar ajror. Miratimi i tyre do te behet sipas rregullave te percaktuara ne marreveshjet qeveritare.